



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHIJAK
NJESIA E PROKURIMIT**

Nr ____ Prot

Date 12.12.2023

Shtojca 12 [Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (PARAPRAK)

Drejtuar: A.L-ASFALT nr Nipt K81511508A dhe Adrese: Xhafzotaj “Sallmone” rruga e Hoxhajve

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-85618-10-27-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **Rikonstruksoni i 7 rrugëve të brendshme në bashkinë Shijak dhe Nj.A.Gjepalaj ,**

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 4 muaj nga dita e nënshkrimit të kontratës

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. A.L- ASFALT nr Nipt K81511508A

Vlera 39.999.568

(tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) leke pa TVSH

2. BOE NDERTIMI sh.p.k nr Nipt K11325002C dhe ARB & amp TRANS-2010 me nr Nipt L02325001T

Vlera 28.710.420 (njëzetë e tetë milion e shtatëqind e dhjetë mijë e katërqind e njëzete) leke pa TVSH

3. L.T.E CONSTRUCTION nr Nipt L78006801F

Vlera 34.799.310,55

(tridhjetë e katër milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dhjetë presje pesëdhjetë e pesë) leke pa TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

BOE NDERTIMI sh.p.k nr Nipt K11325002C dhe ARB & amp TRANS-2010 me nr Nipt L02325001T

Vlera 28.710.420 (njëzetë e tetë milion e shtatëqind e dhjetë mijë e katërqind e njëzete) leke pa TVSH

Arsyet si me poshte :

1- Nga verifikimi i kryer në shtojcën 8 (vetëdeklarim) e dorëzuar nga operatori ekonomik rezulton se : Operatorët Ekonomik nuk kanë deklaruar subjektet mbi kapacitetet e të cilave do të mbështeten, të dy operatorët duhet të deklaronin në paragrafin

B:DEKLARATË Për nënkontratorët dhe subjektet në kapacitetet e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Emrat e Operatorëve Ekonomikë në të cilat do të mbështetet për të përmbushur kriteret e kërkuara në DST .

2- Operatori Ekonomik “ARB TRANS” bilancin e vitit 2020 e ka të pa konfirmuar nga Dega e Tatim Taksave sic kërkohet në DST “Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3(tri) viteve të fundit financiarë (2020,2021,2022) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar .

3- Nga verifikimi i kryer në shtojcën 8 (vetëdeklarim) e dorëzuar nga Operatori Ekonomik rezulton se :Operatori nuk ka deklaruar Frezë Gjeryese asfalti me gjerësi 2M (e shoqëruar me skedën e makinerisë) sic kërkohet në DST, Freza e deklaruar nga OE Ë100F, është me gjerësi 1m,dhe nuk përmbush kriteret e kërkuara në DST .

4- Nga verifikimi i kryer në shtojcën 8(vetëdeklarim) e dorëzuar nga operatori ekonomik rezulton se: Bashkimi i Operatorëve Ekonomik nuk ka deklaruar sharre asfalti copë 2 pasi nuk ka deklaruar të dhënat përkatëse (nr dhe datën e faturës së shitjes ose nr dhe datën e deklaratës doganore ose nr dhe datën e kontratës së shitblerjes.)

5- Nga verifikimi i kryer në shtojcën 8(vetëdeklarim) e dorëzuar nga operatori ekonomik rezulton se: Bashkimi i Operatorëve Ekonomik nuk ka deklaruar vibrator betoni copë 2, pasi nuk ka deklaruar të dhënat përkatëse (nr dhe datën e faturës së shitjes ose nr dhe datën e deklaratës doganore ose nr dhe datën e kontratës së shitblerjes.)

6- Nga verifikimi i kryer OE mbështetës ArbTrans rezulton me detyrime të pashlyera sipas vërtetimit të sjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Tiranë gjë që tregon mosbesueshmëri për subjektin.

L.T.E CONSTRUCTION nr Nipt L78006801F

Vlera 34.799.310,55

(tridhjetë e katër milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dhjetë presje pesëdhjetë e pesë) leke pa TVSH

Arsyet si me poshte :

- 1- Nga verifikimi i kryer në shtojcën 8 (vetëdeklarim) e dorëzuar nga operatori ekonomik rezulton se : Operatori ka deklaruar 1 autograjder në DST Autoriteti Kontraktor kërkon 2 autograjder sipas DST.
- 2- Nga verifikimi i kryer në shtojcën 8 (vetëdeklarim) e dorëzuar nga Operatori Ekonomik rezulton se :Operatori nuk ka deklaruar Automjet teknologjik për pastrimin e kolektorëve të bllokuar, e pajisur me bot me kapacitet bartës (9-12 ton), e pajisur me pompë vakumi për thithjen e materialeve të ngurta për pastrimin e kanalizimeve të bllokuara të rrugëve sic kërkohet në DST
- 3- Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur Licensën e kategorisë III.2.B sic kërkohet në pikën II.2 të DST - Faza: Kriter i përgjithshëm
gjergj cifligu: Oferta juaj për tenderin REF-85618-10-27-2023, “Rikonstruksion i 7 rrugeve te brendshme në Bashkinë Shijak dhe Nj.Ad.Gjepalaj”.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë A.L- ASFALT me adrese :
Xhafzotaj, “Sallmone” Rruga e Hoxhajve , se oferta e paraqitur me vlerë totale prej Vlera
39.999.568

(tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) leke pa TVSH

është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

NJESIA E PROKURIMIT

A.Mehmeti

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ELTON ARBANA